



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE KËRKESAVE PËR PËRZGJEDHJEN E
SHOQËRISË AUDITUESE PËR SHOQËRINË E SIGURIMIT

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 37, datë 28.05.2015
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 141, datë 30.07.2018
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 98, datë 29.07.2020
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 167, datë 29.09.2022

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese të shoqërive të sigurimeve dhe risigurimeve.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 123, pika 6, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit, të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe risigurimi në klasat e Jetës dhe Jo-Jetës, në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4
Kriteret për përzgjedhjen e shoqërisë audituese

1. Shoqëria e auditimit, e regjistruar në regjistrin publik, e shoqërisë së sigurimit, përveç kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në Ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” plotëson edhe kriteret e mëposhtme:
 - a. Të paktën 3 (tre) vjet përvojë në fushën e auditimit ligjor të subjekteve financiare që zbatojnë Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar;
 - b. Të paktën dy prej ortakëve ose të punësuarve të shoqërisë me titull profesional “auditues ligjor”;
 - b/1. Shoqëria e auditimit duhet të ketë si pjesë të brendshme të strukturës së shoqërisë, burimet njerëzore me kompetencat e duhura profesionale për të kryer auditimin ligjor, ku ekipi i auditimit (pa përfshirë ortakun kryesor të auditimit dhe aktuarin) të ketë minimumi dy anëtarë me përvojë në mbikëqyrjen dhe kryerjen e angazhimeve të auditimeve ligjore;
 - b/2. I njëjti ekip auditimi, përfshirë edhe aktuarin e kontraktuar nga shoqëria e auditimit, të mos jetë i angazhuar në më shumë se tre auditime të shoqërive të sigurimit;
 - c. Gjatë dy viteve të fundit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, nuk i ka kërkuar shoqërisë audituese ribërjen e auditimit të kryer prej tij, sipas përcaktimeve të nenit 127 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit;
 - d. Të mos kenë konflikt interesi me shoqërinë që auditon, sipas përcaktimeve të Ligjit 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor” dhe kërkesave përkatëse të Kodit të Etikës dhe ligjeve të fushës;
 - e. Të ketë një aktuar vendas ose të huaj të certifikuar dhe të kontraktuar, i cili duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:
 - i. Të ketë përvojë, të paktën, 5 (pesë) vjeçare në fushën e aktuaristikës;
 - ii. Të mos jetë i angazhuar në të njëjtën kohë në kryerjen e shërbimeve aktuariale në një shoqëri tjetër sigurimi;
 - iii. Të mos ketë qenë i punësuar dhe mos të ketë ofruar kryerjen e shërbimeve aktuariale, në 2 vitet e fundit në shoqërinë që auditohet;
 - iv. Të mos ketë kryer shkelje të rënda të rregullave të profesionit të aktuarit dhe Kodit të Etikës.
 - f. Të mos jetë subjekt i parashikimeve të nenit 55, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor”, sipas afateve të përcaktuara në vendimet përkatëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
2. “Ortaku kryesor i auditimit” ose të punësuarit e shoqërisë audituese me titull profesional “auditues ligjor”, plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - a. Të paktën 3 (tre) vjet përvojë në fushën e auditimit të subjekteve financiare që zbatojnë Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar;
 - b. Të mos kenë konflikt interesi me shoqërinë që auditon, sipas përcaktimeve të Ligjit 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizmin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar dhe kërkesave përkatëse të Kodit të Etikës dhe ligjeve të fushës.

3. Në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese, kriteret e përcaktuara në pikën 1, shkronja “a” dhe “b” dhe pikën 2, shkronja “a” të këtij neni, duhet të plotësohen bashkërisht nga të dyja shoqëritë audituese, ndërkohë kriteret e tjera të këtij neni plotësohen nga secila prej shoqërive audituese.

Neni 5

Dokumentacioni i kërkuar

1. Për miratimin e shoqërisë audituese, shoqëria e sigurimit paraqet pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare një kërkesë me shkrim të shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Vendimin e asamblesë së aksionarëve të shoqërisë administruese për emërimin e shoqërisë audituese apo emërimin e shoqërive audituese kur auditimi do të kryhet në mënyrë të përbashkët nga dy shoqëri audituese;
 - b. Metodologjinë e auditimit të propozuar duke përfshirë theksin në fushat kryesore dhe qasja përkatëse e auditimit. Programin e auditimit të shoqërisë dhe ekspertë të jashtëm të angazhuar nga shoqëria e auditimit;
 - c. Letrën e angazhimit të shoqërisë audituese për aktivitetin e shoqërisë në Shqipëri, si dhe për aktivitetin e konsoliduar të shoqërisë, e cila përvec angazhimit për përmbushjen e kërkesave ligjore në fuqi, duhet të përfshijë edhe trajtimin e çështjeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, për shoqëritë që janë subjekt i ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”. Letra e angazhimit të shoqërisë audituese duhet të parashikojë edhe:
 - i. Komunikimin e shoqërisë së auditimit me komitetin e auditimit;
 - ii. Letrën e drejtimit; si edhe
 - iii. Letrën e përfaqësimit.
 - d. Vërtetim nga Organizata profesionale e audituesve ligjorë/Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, që vërteton se:
 - i. shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese, është person juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari audituese në Republikën e Shqipërisë; dhe
 - ii. Shoqëria audituese ose të paktën njëra prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese ka jo më pak se 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve financiare që zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar (SNRF-ve);d/1. Vërtetim nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), që vërteton se “ortaku kryesor i auditimit” ose të punësuarit e shoqërisë audituese/shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët, me titull profesional “auditues ligjor” kanë jo më pak se 3 (tre) vite përvojë në fushën e auditimit të pasqyrave financiare të subjekteve financiare që zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar (SNRF-ve);
 - e. Të dhëna në lidhje me aktuarin e certifikuar dhe të kontraktuar nga shoqëria audituese, përfshirë certifikatën e aktuarit si dhe kontratën për shërbimet aktuariale. Të depozitohet gjithashtu një vetëdeklarim nga aktuari i kontraktuar, në lidhje me:

- i. Ushtrimin e shërbimeve aktuariale gjatë 3 (tre) viteve të fundit dhe angazhimet për vitin në vijim;
 - ii. Përvojën e kërkuar në fushën e aktuaristikës si dhe zbatimin e rregullave të profesionit aktuarial dhe kodit të etikës.
- f. Vërtetim nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, mbi plotësimin e kriterëve të përcaktuara në nenin 4, pika 1, shkronja “f” të kësaj rregulloreje nga shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese;
 - g. Deklaratë për përmbushjen e kërkesës së parashikuar në nenin 4, pika 1, shkronja “f” dhe pika 2, shkronja “b” të kësaj rregulloreje nga shoqëria audituese ose secila prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët nga dy shoqëri audituese;
 - h. Deklaratë mbi plotësimin e kriterëve të përcaktuara në nenin 124, pika 2 të Ligjit 52. datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;
 - i. Dokumente apo informacione shtesë të kërkuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi.

1/1. Në rastin e auditimit të përbashkët nga 2 shoqëri audituese, për dokumentat e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, duhet të depozitohet një dokument të përbashkët. Për dokumentat e parashikuara në shkronjat “f”, “g”, “h” dhe “i” të pikës 1, të këtij neni, të dorëzohen për secilën nga shoqëritë audituese në rast auditimi të përbashkët.

- 2. Kërkesa dhe dokumentacioni paraqitet në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të noterizuar. Në rastin e dokumentacionit në gjuhë të huaj, ky i fundit paraqitet në origjinal ose kopje e noterizuar dhe duhet të shoqërohet nga kopja e përkthyer dhe e noterizuar në gjuhën shqipe.

Neni 6

Procedura për miratimin e shoqërisë audituese

- 1. Kërkesa dhe dokumentacioni i plotë për miratimin e shoqërisë audituese, depozitohet në Autoritet nga shoqëria e sigurimit jo më vonë se data 31 korrik i çdo viti kalendarik.
- 2. Autoriteti nëse e gjykon të nevojshme, i kërkon shoqërisë së sigurimit plotësim dokumentacioni dhe informacion shtesë brenda një afati të caktuar nga Autoriteti.
- 3. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, brenda 2 (dy) muajve nga data e paraqitjes së plotë të kërkesës miraton ose refuzon shoqërinë audituese të propozuar nga shoqëria.

Neni 7

Refuzimi i shoqërisë audituese

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare refuzon shoqërinë audituese të propozuar nga shoqëria e sigurimit nëse nuk përmbushen kriteret dhe kërkesat e parashikuara në Ligjin Nr. 52. datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” dhe në këtë rregullore.

Autoriteti ka të drejtë të refuzojë shoqërinë/shoqëritë audituese, nëse gjatë kontrollit të cilësisë së punës së tyre, shoqëria ose njëra prej shoqërive audituese në rastin e auditimit të përbashkët

nga dy shoqëri audituese, në tre vitet e fundit, (në rastet kur është kryer një kontroll i tillë), është vlerësuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, nën notën C.

Neni 8

Ndryshimi dhe zëvendësimi i shoqërisë audituese

1. Ndryshimi i shoqërisë audituese, brenda vitit financiar për të cilin është miratuar, bëhet me miratimin paraprak të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Për këtë qëllim, shoqëria duhet të depozitojë në Autoritet dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. Kërkesën për ndryshimin e shoqërisë audituese;
 - b. Shkaqet dhe arsyet e ndryshimit të shoqërisë audituese;
 - c. Dokumentacionin e përcaktuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje.
2. Për ndryshimin dhe zëvendësimin e shoqërisë audituese zbatohen kriteret e përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 9

Dispozita të fundit

1. Rregullorja nr. 7, datë 08.02.2007 “Për ekspertët kontabël të autorizuar”, e ndryshuar nuk zbatohet për tregun e sigurimeve.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.